

KËRKESË
Nr. 4766, datë 4.10.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë–Elbasan (shtesa)”, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “objekte”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “objekte”. Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 53 424 593 (pesëdhjetë e tre milionë e katërqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “TIRANË - ELBASAN (SHITESA)”

Nr.	PRONARI	ZK	NR. PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE	VLERËSIMET			Sip. e banesave (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Hanesat vlera (lekë)	VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emri i pronarit					SIP (M2)	CMIMI (LEKË/M2)	Vlera(lekë)					
1	Zylfie Tahir Metani	2735	113/13	Arë	1500	287	399	114513				114513	Konfirmim ZVRPP
2	Zamir Rexhep Metani	2735	113/4	Arë	2050	361	399	144039				144039	Konfirmim ZVRPP
3	Zamir Rexhep Metani	2735	125/9	Arë	5000	3261	399	1301139				1301139	Konfirmim ZVRPP
4	Zamir Rexhep Metani	2735	125/2	Arë	625	625	399	249375	372.7	64500	24039150	24288325	Konfirmim ZVRPP + Lega ndërtimi 3 lit
5	Zamir Rexhep Metani	2735	115/3	Arë	510	510	399	203490				203490	Konfirmim ZVRPP
6	Dashkezpronarët Metani	2735	115/2/1	Truall	300	300	3560	1068000	100	64500	6450000	7518000	Konfirmim ZVRPP
7	Shatë	2735	115/5	Truall	300	300	3560	1068000	77.5	64500	4998750	6066750	(pretenden Ramazan Metani)
8	Dashkezpronarët Metani	2735	115/3/1	Truall	300	300	3560	1068000	120	64500	7740000	8808000	Konfirmim ZVRPP
9	Shatë	2735	115/4	Truall	250	130	3560	462800	48.15	64500	3105675	3568475	Konfirmim ZVRPP (pretendoj Ali Metani)
10	Selman Dervishi	2735	125/13	Arë	1300	816	399	325584				325584	Konfirmim ZVRPP
10	Selman Dervishi	2736	125/14	Arë	1300	816	399	325584				325584	Konfirmim ZVRPP
10	Selman Dervishi	2737	125/15	Arë	1300	816	399	325584				325584	Konfirmim ZVRPP
11	Selman Dervishi	2735	127/4	Arë	5800	1090	399	434910				434910	Konfirmim ZVRPP
TOTALI						9612		7091018	718.38		46333875	83424593	